

01-34
15.01.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e parë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më 20.01.2020 (e hënë) duke filluar në orën 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raporti vjetor i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;
3. Aprovimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020;
4. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve;
5. Të ndryshme;

Me: 14.01.2020
Në: Novobërdë

Shpresa Kallika
Kryesuese e Komitetit për Komunitete

01-35
15.01.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo-Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e njëmbëdhjet e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 12.12.2019, duke filluar në orën 11:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Zymer Zymeri, Abdyl Gashi, Behare Jashari, Jorgovanka Filic, Shefja e ZKKK Jasmina Denic, përfaqësuesi i fshatit Pasjak Naser Ibrahim, përfaqësuesit i OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshëndeti të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Shqyritimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2019 dhe hartimi i planit të punës për vitin 2020;
3. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore;
4. Rregullimi i kanalizimit në Pasjak, banorit të fshatit Hasan Matoshi;
5. Hapja e pusit me ujë të pishëm për tri familje në lagjen e re Pasjak;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Aprovohet rendi i ditës nga të gjithë antarët prezent të komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë: Shqyritimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2019 dhe hartimi i planit të punës për vitin 2020;

Kryesuesja tha: raportin vjetor të punës e kam pregadit por ende nuk është perkthyer për arsye të angazhimeve të shumta të perkthyesit, besoj që për mbledhje të janarit do ta keni, andaj ju lus që këtë pikë ta shtym për muajin Janar, ndërsa planin e punës e kam pregadit vetem si draft po ju lë pak kohë ta analizoni si dhe nese keni me shtu ndonjë pikë.

Aleksander Pavic pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i përket raportit të punës mendoj se mundeni ta shtyni për mbledhjen e ardhshme, ndërsa planin e punës mund edhe ta shqyrtojmë dhe ta diskutojm në këtë mbledhje.

Kryesuesja tha: nese keni ndonjë propozim ne mundimi edhe ta lëjm një takim në javen e parë të janarit e pastaj ta shqyrtojm pasi që është vetem draft.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: mendoj se punën që e kemi bërë ne si komitet për komunitete e kemi bërë me mjaft vështërsi, besoj që viti i ardhshëm të jetë më i mirë në mes të komunitetit dhe qeverisjes qendrore për arsye se shumë herë kemi pasur penges dhe nuk kemi arrit që ti marrim informatat e duhura. Asnjëher të vetme nuk e kemi pas Kryetarin e Komunës në një mbledhje të vetme.

Pika e tretë: Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore;
Për këtë pikë ja dha fjalën shefes së ZKKK Jasmina Denic.

Jasmina Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimisht do të raportoj rreth aktiviteteve mujore e pastaj do të ndalem rreth planeve aksionale pasi i permendet ju më herët si dhe për mbledhje të janarit ju lus që të jetë edhe pika për raportin e gjashtëmujorit të dytë të ZKKK. Kemi pasu 5 raste në terren nga DRC për renovime e dini se më herët ju kam njoftuar se para dy muajve kemi nënshkruar memorandumin e bashkpunimit dhe njerëzit kanë filluar të aplikojn por ne kemi më shumë kërkesa për ndërtim të shtëpive e më pak për renovime. Për 5 këto kërkesa kemi dal në terren se bashku me Ministrin për kthim dhe këshillin danez i kemi vizituar këto familje dhe kemi pregaditur dokumentacionin por ende nuk janë hyr në ndonjë list të ngusht vetem kemi qenë te këto familje. Mos ti perseris të gjitha që i kam permend në muajin e kaluar por ju lus që antarë të komitetit të punoni dhe ejani me kërkesa konkrete në momentin që paraqitet një donator ti kem kërkesat. Kur i kam propozuar projektet në komitetin për komunitete kamë pasur propozime edhe nga ky komitete, sa do që thuani se zyrja për kthim dhe komunitete duhet të bashkpunoj me ju por edhe ju duhet të bashkpunoni me ne, do të doja të kemi më shumë vërejtje dhe kritika pasi që vetem ashtu mundë të përmirësohemi dhe të punojmë më shumë, edhe pse nuk kanë mundur të hynë të gjitha propozimet por ato që kanë hyr janë aprovuar nga këshilli danez. Kemi pasur një projekt që është realizuar në shkollën fillore në Pasjak dhe një në shtëpin e kultures në Zebinc dhe ky projekt ka qenë mbrojtja e ambientit nga IOM dhe kryesuesja e komitetit ka marrë pjesë, mendoj se ajo shume është shpenzuar mirë dhe kemi mbjell drunjë për një ambient të mire. Nese ju kujtohet kemi biseduar edhe për projektet e panelev djellore të cilat në kuader të këtij projekti për mbrojtje të ambientit kemi menduar ti realizojm, ne i kemi dhënë propozimet tona. Besoj se e dini që ka qenë 16 ditëshi për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe zyrja jonë së bashku me barazin gjinore na ka ftuar që të marrim pjesë në tryez të rrubullakët dhe kemi biseduar për një rast që e kemi pasur në Komunën tonë. Do të klop në qështjen e planeve dhe siç e dini asnjëri plan nuk është aprovuar në Kuvend, në rregull është por ajo që më ka befusuar është se nuk ka pasur asnjë reagim në Kuvend dhe duke degjuar diskutimet e tuaja më herët tju pergjigjem pasi që Zyrja për KK nuk është zyre politike dhe është e rregulluar edhe me ligj që mos të jetë zyre politike. Ajo që ka ndodh atë ditë në Kuvend është shqetësuese për të gjith ata që deshirojnë të kthehen dhe të kthyerit si dhe të riatdhesuarit, në momentin që keni kerkuar që ne si zyre të jemi prezent në takimet tuaja ne kemi pranuar si dhe ne si zyre jemi obligativ që të paraqes raportin mujor para jush, dikush e permendi se niveli qendror dhe lokal duhet të bashkpunojnë ndërsa në anen tjetër vet fakti i mosaprovimit të këtyre planeve më ka habit pasi që është edhe obligim moral dhe ligjor që të aprovohen. Me mosaprovim të këtyre planeve po ju mbyllim rrugën atyre që kanë nevoj për ndihmë. Atë qe e permendi më herët Beharja personat e hendikepuar në ato plane kanë qenë edhe ata persona si dhe personat e marginalizuar dhe persoant e rrezikuar në mënyr sociale të komunitetit rom. Po më duket pak e quditshme sot po bisedojm për mbrojtjen e personave ndërsa në anen tjetër atë dite në Kuvend nuk u aprovuan planet aksionale pa asnjë arsyetim. Tju them për fund unë nuk e perjetoj veten si pushtet por unë e di detyren time se kam për obligim ti perfaqësoj grupet e marginalizuara dhe i përfaqësoj vetem ata që kanë nevoj për ndihmë andaj kerkoj nga ju që së bashku tju dalim në ndihmi, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrovoje Djodrejcic tha: sdua ta mbroj vendimin e Kuvendit por po e mbroj qendrimin tim. Nese ju kutjohet këtu para disa mbledhjeve kemi pyetur se a i përcjellni rastet kur dikush deklarohet se po kthehet i ndertohet shtepia e pastaj e shet dhe ju të mos i mbyllni syt por të shohim se kujt po i ndertohen shtepit, kemi persona që më të vërtet kanë nevoj për ndihmi por ka edhe persona qe din të

bëjnë politik udhëheqësve, ka persona që ka vertet nevoj për ndihme po vetem 1% marrin ata që kanë nevoj për ndihmi.

Zymer Zymeri tha: une e kam një pyetje për Jasminen a merrni mjete ju nga Buxheti i Kosovës, nga po i ndertoni shtëpit me çfarë mjete?

Jasmina Denic tha: 70% të mjeteve janë të kshillitë të Evropes dhe 30% janë të Ministrisë për komunitete dhe kthim, të gjitha kërkesat shkojnë në bord qendror dhe bordi qendror vendos se kujt ti ndertohen shtëpit.

Zymer Zymeri tha: unë sa kam degjuar në TV 114 milion € prej 2005-2015 janë dhënë për ndertim të shtëpive për serbët.

Jasmina Denic tha: nga buxheti i Qeveris i marim vetem pagat, ne si zyre në Komunën e Novovërdës nuk kemi mjete që të ndertojm shtëpi, sikur qendra për punë sociale që nuk i ka mjetet e veta por ndarja e mjeteve për raste sociale është e rregulluar me ligj ashtu është dhe te ne çdo gjë është e rregulluar me ligj.

Zymeri Zymeri tha: propozimi im është që të gjitha komunitetet të përfitojnë njëjtë, që 4 vite asnjë shtëpi dhe material nuk ju është dhënë komunitetit shqiptarë.

Jasmina Denic tha: sa i perket të riatdhesimit të gjithë kanë qenë të komunitetit shqiptarë por nuk u aprovu në Kuvend plani për riatdhesim.

Jorgovanka Filic pasi pershendeti të pranishmit tha: pavarësishtë asaj a e ka shit dikush token apo jo i ka 2 ari ne duhet ti ndihmojmë keni votuar kunder diçka që ka qenë për të miren e qytetarëve, ka padrejtësi, ka parregullësi, shumë e kam ndi veten keq kur nuk janë aprovuar këto dy plane, kam prit që kolegt të dhëjne ndonjë replik por të mos ipet asnjë argument e të mos votohen këto plane, skam mujt me kuptu se si ti nuk reagoje pasi që gjithëmon reagon.

Abdyl Gashi tha: është e drejt e secilit me votu për ose kunder, me shpreh mendimin e vet, ne e kemi një bashkpunëim shumë të mirë me një pjesë që e përfaqësojn edhe komunitetin serb dhe kemi parë padrejtësi të shumta që janë bërë në procesin e ndarjes dhe normalisht ju kam bashkangjit shumices.

Pika e katërt: Rregullimi i kanalizimit në Pasjak, banorit të fshatit Hasan Matoshi; Për këtë fjal Kryesuesja ja dha fjalën Naser Ibrahimit perfaqësusit të fshatit.

Naser Ibrahimit pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi jamë përfaqësues i fshatit unë kam bërë këtë kërkes, është një familje që ju ka ndertu shtëpia duke iu ndihmuar të gjithë të gjithë ne kemi participura dhe është 150m larg për kanalizim ne kemi tentuar edhe përmes Komunës që ti ndihmojn por nuk i kanë ndihmuar dhe e di se buxheti i komunitetit është 0 por kerkoj që ta perkrahni për në Kuvend që ta sanojmë atë problem, nese ka ndonjë pyetje unë jam këtu.

Behare Jashari tha: e kam edhe unë një problem në rrugen afer shkollës, kanë qenë niher e kan rregullu atë kanalizim mjeshtrit por perseri rrjedhi uji.

Kryesuesja tha: a pajtoheni që ta perkrahmi këtë pikë që të shkoj në Kuvend?.

Aprovohet njëzëri nga antarët e pranishmëm të Komitetit që të shkoj në Kuvend.

Pika e pestë: Hapja e pusit me ujë të pishëm për tri familje në lagjen e re Pasjak;

Për këtë fjal Kryesuesja ja dha fjalën Naser Ibrahimit perfaqësusit të fshatit.

Naser Ibrahimit tha: është e vertete edhe kjo pasi që tri familje marin ujë shumë larg, keni degjuar se ka filluar furnizimi me uje prej Koretishtes në Pasjak por në lagjen e re nuk ka ujë për at unë si përfaqësues kerkoj nga ky komiteti të na perkrah dhe të ndaj mjete në hapje të një pusi, ne i kemi mbledh disa mjete dhe kemi mundësi edhe të participojm, por kerkoj që tju bëhet një zgjidhje. Dje kam qenë në teren në Kufc me të vertet komiteti për komunitete duhet të dal dhe të shoh çdo fshat pasi ka njerëz që jetojn ë gjendje të mjerueshme dhe në fshatin tonë ka familje që nuk kan mundësi të hapin pus, andaj kerkoj nga ju që ta perkrahni edhe këtë pikë për Kuvend

Zymer Zymeri tha: së pari këto pika duhet të shkojnë në KPF dhe unë jam që ti perkrahim jo vetem për Pasjak por në çdo vend ku ka nevojë.

Kryesuesja tha: a pajtoheni që ta perkrahmi këtë pikë që të shkoj në Kuvend?.

Aprovohet njëzëri nga antarët e pranishmëm të Komitetit që të shkoj në Kuvend.

Pika e gjashtë: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Behare Jashari tha: kemi shumë probleme, së pari rruga kemi bërë shumë kërkesa por që shumë vite nuk është ndertu asfalti në rrugen në lagjen e Romëve, kerkoj edhe kjo pikë të jetë në Kuvend, kërkesa e dytë po flas për një vajzë të verber Esma Jashari asaj i ka vdek e ëma që disa muaj ajo i ka dergu kerkes Kryetarit për ndihm por nuk ka pergjigje, unë e di që ka mjete për persona me aftësi të kufizuara dhe kerkoj që ti ndihmohet Esmës.


Dobriwoje Djordjevic tha: po i drejtohem Shpreses që për komitetin e radhes para se të pregaditet rendi i ditës i kam dy propozime për rend dite, ujësjellësi ne Stanishor dhe rregullimi i rrugës për fshatin Stanishor-Strazh.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 12:25.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku

Kryesuese i Komitetit për Komunitete